



Pranuar / Dërguar Prenjeto / Predato Received / Delivered		09.02.2022		2	viti god year
Organ / Alesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity		
B.KRYSHK	637/2022		1/3		



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.76/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.76/2021 të datës 01.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/ Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në çështjen juridike-administrative "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 09.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.76/2021 të datës 01.02.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 01.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të testit me shkrim nga Komisioni Vlerësues i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent lidhur me procedurën e konkursit për pozitën Zjarrfikës në Komunën e Gjakovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi dhe poentimi ka qenë jo korrekt në testin me shkrim, anashkalim të kriterëve të konkursit, shkelje të ligjit për konflikt të interesit dhe tejkallim të afatit ligjor për shqyrtim të ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.02.2022 me nr.protokolli 436/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin e datës 04.08.2021 për pozitën Zjarrfikës dhe Vozitës; Njoftimin e datës 22.10.2021 për rezultatet e testimit me shkrim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent; Procesverbalin e datës 04.11.2021 lidhur me renditjen e kandidatëve të

suksesshëm në testin me shkrim dhe intervistën me gojë; Vendimin e datës 04.11.2021 lidhur me njoftimin mbi kandidatin e suksesshëm për pozitën zjarrfikës në Komunën e Gjilanit; Kërkesën e datës 25.10.2021 e parashtruar nga ankuesi për verifikimin e testit me shkrim; Aplikacionin për punësim të ankuesit i datës 07.09.2021; Kopjen e ID-së së ankuesit; Ankesën e ankuesit të datës 25.01.2021; E-mailin e datës 07.12.2021; Kërkesën për punësim të ankuesit me shkresat e bashkangjitura të lëndës mbi përvojën e shkollimit dhe atë profesionale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi. **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin me nr.prot:316 të datës 04.08.2021, të shpallur nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent për pozitën e punës "Zjarrfikës", në Departamentin Zjarrfikje dhe Shpëtim/Njësitë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Komunën e Gjakovës. I njëjti me datë 01.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të testit me shkrim nga Komisioni Vlerësues i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent lidhur me procedurën e konkursit për pozitën Zjarrfikës në Komunën e Gjakovës, me pretendimet ankimore që vlerësimi dhe poentimi ka qenë jo korrekt në testin me shkrim, anashkalim të kriterëve të konkursit, shkelje të ligjit për konflikt të interesit dhe tejkalim të afatit ligjor për shqyrtim të ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrтарët Publikë përkatësisht nenin 2 paragrafit 4 ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike."*, ka konstatuar se pozita "Zjarrfikës", hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik gjegjëshit nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil, fakt ky i theksuar edhe në vet dokumentin për shpalljen e konkursit me nr.prot:316 të datës 04.08.2021, Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.76/2021 të datës 01.02.2022, të parashtruar nga e ankuesi


Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrтарët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënës dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.76/2022

Ardita Percuku-SHYTI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

